



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 140**

**31 tetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 96/2012 datë 11.10.2012	Për Qendrën e Botimeve Zyrtare ..... 7837
Ligj nr. 97/2012 datë 18.10.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për bashkëpunim në lidhje me huadhënien e objekteve, që i përkasin trashëgimisë së luajtshme kulturore të shtetit, për ekspozim në territorin e shtetit tjetër ..... 7842
Ligj nr. 98/2012 datë 18.10.2012	Për miratimin e Buxhetit faktik të Shtetit për vitin 2011..... 7845
Ligj nr. 99/2012 datë 18.10.2012	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 26.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” ..... 7846
Vendim i KM nr. 657, datë 26.9.2012	Për miratimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunim në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës ..... 7847
Vendim i KM nr. 712, datë 16.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për mbulimin e shpenzimeve të konkurseve dhe veprimtarive kulturore me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë ..... 7848
Vendim i KM nr. 713, datë 16.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar, Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe dhe realizimin e dramës fituese, shpallur në konkursin me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë ..... 7849
Vendim i KM nr. 714, datë 16.10.2012	Për kthimin në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar shqiptar, Mbretit Zog I ..... 7849

**LIGJ**  
**Nr. 96/2012**

**PËR QENDRËN E BOTIMEVE ZYRTARE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi:

- a) i procedurës së botimit të Fletores Zyrtare në formatin e shkruar në letër, si dhe në formatin elektronik;
- b) i përgjegjësiive të institucioneve të përfshira në procesin e botimit të akteve;
- c) i rregullave për të garantuar mirëfunksionimin e Arkivit Elektronik të Akteve;
- ç) i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për botimin e ligjeve, të akteve normative të Këshillit të Ministrave, ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vendimeve për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha akteve të tjera, botimi i të cilave është i detyrueshëm me ligj, në funksion të bërjes së mundur të hyrjes në fuqi të tyre, si dhe për të garantuar njohjen e legjislacionit dhe garantimin e së drejtës për informim të personave fizikë dhe juridikë, si dhe institucioneve shtetërore.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akte të botueshme” janë të gjitha aktet, botimi i të cilave në Fletoren Zyrtare parashikohet në Kushtetutë dhe në legjislacionin në fuqi.
2. “Botim” është bërja e njohur botërisht, në formë të shkruar dhe/ose elektronike, e akteve të botueshme. Botimi në Fletoren Zyrtare përfshin botimin e të gjitha akteve të botueshme, sipas versionit të tyre përfundimtar, pas procedurës së miratimit. Botimi në Arkivin Elektronik të Akteve përfshin botimin e Fletores Zyrtare në të, si dhe botimin e akteve të përditësuara, së bashku me ndryshimet e tyre.



3. “Përditësim” është procesi i pasqyrimin të ndryshimeve të aktit në tekstin bazë të tij. Akti i përditësuar është akti i botueshëm, së bashku me ndryshimet e pësuara, në një tekst të vetëm integral dhe që pasqyron variantin në fuqi të tij.

## KREU II BOTIMI NË FLETOREN ZYRTARE

### Neni 4 Fletorja Zyrtare

1. Fletore Zyrtare është dokumenti zyrtar, në formatin në letër dhe në atë elektronik, në të cilin gjendet i pasqyruar teksti i aktit të botueshëm, në versionin përfundimtar të tij, pas procedurës së miratimit.

2. Qendra e Botimeve Zyrtare është institucioni përgjegjës për realizimin e botimit të Fletores Zyrtare, duke mundësuar hyrjen në fuqi të akteve të botueshme, si dhe njohjen e tyre nga publiku.

3. Fletorja Zyrtare botohet në formatin në letër nga Qendra e Botimeve Zyrtare, sipas nevojave dhe kërkesave për përfitimin e këtij shërbimi nga abonentët. Tirazhi i nevojshëm i fletoreve zyrtare në formatin në letër përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

4. Si rregull, Fletorja Zyrtare botohet një herë në javë. Botime të veçanta të Fletores Zyrtare, në formatin në letër dhe në atë elektronik, bëhen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

5. Rregullat dhe kriteret teknike, formati, procedurat e përgatitjes për botim, autorizimi i botimit, mënyra e vënies në qarkullim dhe shpërndarja e Fletores Zyrtare përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Qendrës së Botimeve Zyrtare.

### Neni 5 Dërgimi i akteve për botim

1. Teksti i akteve të botueshme i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare në formatin e shkruar në letër dhe në format elektronik brenda 5 ditëve pas miratimit nga institucionet shtetërore përkatëse.

2. Në rastin e dërgimit për botim të ligjeve, akti i botueshëm dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 ditëve nga njoftimi i dekretit të Presidentit për shpalljen e ligjit, por në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga data e dekretit.

3. Nëse Presidenti e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend dhe dekreti i tij e humbet fuqinë, akti i botueshëm dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 ditëve nga votimi kundër tij prej shumicës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Nëse Presidenti nuk ushtron të drejtën e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 84 dhe në paragrafin 1 të nenit 85 të Kushtetutës, akti i botueshëm dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 ditëve nga kalimi i afatit kushtetues për shpalljen ose kthimin për rishqyrtim të ligjit. Në këtë rast, Kuvendi shënon edhe datën e dërgimit të ligjit të miratuar te Presidenti i Republikës.

5. Në rastin e dërgimit për botim të ligjeve, të miratuara sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 84 të Kushtetutës, Kuvendi e dërgon aktin e botueshëm menjëherë. Ky ligj botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

6. Institucioni shtetëror, që dërgon aktin e botueshëm, kujdeset që formati elektronik të nënshkruhet elektronikisht. Të dyja formatet kanë vlerë të njëjtë juridike. Në rast mospërputhjeje të dy formateve, Qendra e Botimeve Zyrtare i kërkon institucionit të konfirmojë përmbajtjen e saktë të aktit të botueshëm dhe vetëm pas përgjigjes zyrtare të institucionit dërgues vijon me botimin e aktit.

7. Këshilli i Ministrave përcakton me udhëzim mënyrën, format dhe procedurën e dërgimit të tekstit të akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe formatin e shkruar në letër dhe formatin elektronik të tyre.

#### Neni 6 **Afati i botimit**

1. Aktet e botueshme duhet të botohen pa vonesë pas përpunimit për botim, por sidoqoftë jo më vonë se 10 ditë nga data e ardhjes tyre, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.

2. Në rast të masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë dhe urgjence, Ministri i Drejtësisë urdhëron botimin e aktit brenda një afati më të shkurtër se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 7 **Botimi**

1. Qendra e Botimeve Zyrtare siguron botimin e njëkohshëm të Fletores Zyrtare në formatin në letër dhe në formatin elektronik. Momenti i daljes së Fletores Zyrtare nga botimi konsiderohet data dhe ora e përfshirjes në Arkivin Elektronik të Akteve.

2. Botimet ose konfirmimet e Qendrës së Botimeve Zyrtare kanë vlerë zyrtare dhe përmbajtja e tyre merret e mirëqenë.

3. Pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare çdo subjekt mund të njihet, drejtpërdrejt dhe pa shpërblim, me përmbajtjen e akteve të botuara.

#### Neni 8 **Regjistri shtetëror i akteve**

Në Qendrën e Botimeve Zyrtare krijohet regjistri elektronik dhe shkresor i akteve, ku pasqyrohen të gjitha të dhënat e detyrueshme për botimin, numërtimin, korrektimet gjuhësore e juridike, shënimet në rubrika të veçanta për shfuqizimet, ndryshimet ose shtesat pas miratimit të aktit. Modeli i regjistrit elektronik dhe shkresor miratohet me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë.

#### Neni 9 **Detyrimi për bashkëpunim**

1. Institucionet shtetërore kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Qendrën e Botimeve Zyrtare, duke i siguruar të gjithë informacionin që ajo kërkon në përmbushje të detyrave të saj.

2. Qendra e Botimeve Zyrtare njofton Ministrinë e Drejtësisë në rast të mosbashkëpunimit të institucioneve shtetërore.

3. Institucionet shtetërore kanë të drejtë t'i kërkojnë Qendrës së Botimeve Zyrtare botimin e akteve të botueshme brenda një afati kohor të shpejtë dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 10 **Përgjegjësia për dëmet nga botimet e parregullta**

1. Sipas rastit, institucioni shtetëror që ka dërguar aktin ose Qendra e Botimeve Zyrtare janë përgjegjës ndaj të tretëve për pasaktësi, parregullsi, gabime në përmbajtjen e aktit, ose kur bëhet pengesë për botimin e tij.



2. Kur janë shkaktuar dëme nga botimet e pasakta ose të parregullta, të interesuarit kanë të drejtë të kërkojnë në rrugë administrative dhe gjyqësore vërtetimin e përgjegjësisë ligjore dhe zhdëmtimin e drejtpërdrejtë të dëmit.

### KREU III ARKIVI ELEKTRONIK I AKTEVE

#### Neni 11

#### **Krijimi i Arkivit Elektronik të Akteve**

1. Arkivi Elektronik i Akteve është baza elektronike e të dhënave, që përmbledh të gjitha fletoret zyrtare në formatin elektronik, dhe të gjitha aktet e botuara, që është lehtësisht i përdorshëm dhe me aksesim të plotë nga publiku, në rrugë elektronike.

2. Në Arkivin Elektronik të Akteve botohen të gjitha aktet e botueshme, së bashku me të gjitha ndryshimet e pësuara pas miratimit të tyre. Kur akti i botuar pëson ndryshime pas miratimit, Qendra e Botimeve Zyrtare, gjatë botimit të aktit ndryshues në Arkivin Elektronik të Akteve, përditëson aktin bazë me këto ndryshime. Në Arkivin Elektronik të Akteve botohet, në çdo rast, akti i përditësuar.

3. Arkivi Elektronik i Akteve përmban një rubrikë të posaçme, ku pasqyrohen të gjitha aktet e botueshme, të cilat dalin në bazë dhe për zbatim të një akti tjetër të botueshëm.

#### Neni 12

#### **Administrimi i Arkivit Elektronik të Akteve**

1. Arkivi Elektronik i Akteve administrohet nga Qendra e Botimeve Zyrtare, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Ministri i Drejtësisë, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit Elektronik të Akteve.

2. Aktet e botueshme përbëjnë të dhëna parësore të Arkivit Elektronik të Akteve, por në këtë arkiv botohen edhe të dhëna dytësore, të cilat paraqesin interes publik dhe që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore. Të dhënat dytësore, që botohen në Arkivin Elektronik të Akteve, si dhe mënyra e ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

3. Dhënës të informacionit në Arkivin Elektronik të Akteve janë të gjitha institucionet shtetërore që miratojnë aktet e botueshme.

### KREU IV QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE

#### Neni 13

#### **Statusi i Qendrës së Botimeve Zyrtare**

1. Qendra e Botimeve Zyrtare është person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Punonjësit e Qendrës së Botimeve Zyrtare gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, me përjashtim të punonjësve mbështetës, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës.

3. Struktura dhe organika e Qendrës së Botimeve Zyrtare miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

4. Rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 14  
**Drejtori**

1. Drejtori i Qendrës së Botimeve Zyrtare drejton veprimtarinë e përditshme administrative dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët.

2. Drejtori emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 15  
**Buxheti**

1. Për të siguruar veprimtarinë e saj, Qendra e Botimeve Zyrtare financohet nga Buxheti i Shtetit dhe buxheti i saj miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

2. Qendra e Botimeve Zyrtare siguron burime financiare edhe nëpërmjet donacioneve të ndryshme nga donatorë, vendas e të huaj, ose nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

3. Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme, që i vijnë Qendrës së Botimeve Zyrtare, përdoren sipas rregullave dhe procedurave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

KREU V  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16  
**Dispozitë kalimtare**

1. Kudo në legjislacionin në fuqi, emërtimi “Qendra e Publikimeve Zyrtare” zëvendësohet me emërtimin “Qendra e Botimeve Zyrtare”. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Qendrës së Publikimeve Zyrtare i gëzon Qendra e Botimeve Zyrtare.

2. Arkivi Elektronik i Akteve, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, fillon të funksionojë jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Qendra e Botimeve Zyrtare përgatit bazën e të dhënave shtetërore, sipas rregullave të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, dhe i boton ato në Arkivin Elektronik të Akteve, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 17  
**Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 7 dhe 12 pika 1.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 4, 8, 12 pika 2 dhe 13 pika 4.



Neni 18  
**Shfuqizime**

Ligji nr. 8502, datë 30.6.1999 “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 19  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 11.10.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7797, datë 18.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 97/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR BASHKËPUNIM NË LIDHJE ME HUADHËNIEN  
E OBJEKTEVE, QË I PËRKASIN TRASHËGIMISË SË LUAJTSHME KULTURORE TË  
SHTETIT, PËR EKSPOZIM NË TERRITORIN E SHTETIT TJETËR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për bashkëpunim në lidhje me huadhënien e objekteve, që i përkasin trashëgimisë së luajtshme kulturore të shtetit, për ekspozim në territorin e shtetit tjetër.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.10.2012

**Shpallur me dekretin nr.7801, datë 30.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

## MARRËVESHJE

### NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR BASHKËPUNIM NË LIDHJE ME HUADHËNIEN E OBJEKTEVE QË I PËRKASIN TRASHËGIMISË SË LUAJTSHME KULTURORE TË SHTETIT PËR EKSPOZIM NË TERRITORIN E SHTETIT TJETËR

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Austrisë, më poshtë të quajtura “Palët”,  
*të vetëdijshëm* për lidhjet historike midis Shqipërisë dhe Austrisë dhe për rëndësinë e  
ekspozimit të trashëgimisë kulturore të luajtshme të shtetit, që i përket një shteti në territorin e  
shtetit tjetër;

*me dëshirën* për të forcuar më tej bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë në fushën  
e kulturës;

*duke pasur* parasysh marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e kulturës, arsimit dhe  
shkencës të nënshkruar më 31 tetor 2005;

*duke pasur* parasysh rregullat e së drejtës ndërkombëtare zakonore në lidhje me imunitetin e  
trashëgimisë kulturore dhe objekteve me interes shkencor, kulturor apo historik të kodifikuar në  
konventën e Kombeve të Bashkuara për imunitete juridiksionale të shteteve dhe pasurisë së tyre;  
kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është sigurimi i një kuadri ligjor për marrjen hua të objekteve në  
pronësi të njëres prej Palëve dhe që i përket trashëgimisë së saj të luajtshme kulturore, më poshtë e  
quajtur “Trashëgimi kulturore e luajtshme e Shtetit” për ekspozita në territorin e palës tjetër mbi  
bazën e interesave të përbashkët kulturorë dhe përfitimit të ndërsjellë.

#### Neni 2

1. Secila palë përcakton sipas gjykimit të vet trashëgimisë kulturore të luajtshme të shtetit që  
do të ekspozohet në territorin e palës tjetër si trashëgimi kulturore e luajtshme që mbrohet nga kjo  
marrëveshje (në vijim referuar si trashëgimi kulturore e luajtshme e përcaktuar nga shteti”). Pala  
tjetër njihet pronësinë e Palës përcaktuese të kësaj trashëgimie kulturore të luajtshme të shtetit.

2. Secila Palë gëzon imunitet nga juridiksioni i Palës tjetër për sa i përket trashëgimisë së  
vet kulturore të luajtshme të përcaktuar të Shtetit. Në mënyrë të veçantë, pasuria e luajtshme e  
përcaktuar nuk do të jetë subjekti:

i) ndonjë procedurë gjyqësore apo administrative që lidhet me pronësinë ose të drejtën e  
njëres palë për të disponuar lirisht trashëgiminë e tij kulturore të luajtshme të shtetit;

ii) ndonjë masë kufizimi, duke përfshirë masat e para-gjykimit apo pas-gjykimit, si ndalim  
apo arresti, apo dhe ndonjë formë tjetër masë sekuestrimi, ndalimi, ose masë detyruese përmbarese  
nga ana e autoriteteve gjyqësore ose administrative të Palës tjetër.

3. Secila palë përmbahet nga pretendimi për pronësinë apo të mbështesë pretendimet në  
lidhje me ndonjë trashëgimi të luajtshme kulturore të caktuar shtetërore të Palës tjetër, dhe të mbrojtë  
dhe garantojë të drejtat e Palës tjetër si pronare e veteme me të drejta të plota të trashëgimisë së vet  
kulturore të luajtshme të Shtetit. Në mënyrë të veçantë, ajo garanton kthimin e papenguar dhe të  
menjëhershëm të çdo trashëgimie të luajtshme kulturore të shtetit në përputhje me afatin kohor të  
rënë dakord më parë.

4. Asnjë procedurë gjyqësore ose administrative që lidhet me trashëgiminë kulturore të  
luajtshme të përcaktuar të Shtetit të Palës tjetër nuk do të fillohet apo mbështetet para autoriteteve  
kombëtare përkatëse ose gjykatave.





5. Në rast procedurash, qofshin ose jo në kundërshtim me paragrafin 4 të këtij neni, çdo mospajtim ose refuzim për t'u pajtuar nga njëra Palë me një vendim gjykate të Palës tjetër, urdhërimi për të kryer ose mos kryer një akt të veçantë ose për të siguruar ndonjë dokument, ose për të zbuluar ndonjë informacion tjetër për qëllime të një procedimi, nuk do të sjellë pasoja. Në veçanti, asnjë gjobë ose dënim nuk vendoset ndaj Palës për shkak të një mosveprimi ose refuzimi të tillë. Për më tepër, Palës nuk do t'i kërkohet të ofrojë ndonjë garanci, obligacion ose depozitë, sidoqoftë e përshkruar, për të garantuar pagesën e shpenzimeve gjyqësore ose shpenzimeve për ndonjë procedim në të cilin ajo është palë e paditur para gjykatës së Palës tjetër.

### Neni 3

Në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe standardeve më të larta ndërkombëtare përkatëse, Palët ose autoritete të tjera ose institucione të autorizuar prej tyre për këtë qëllim mund të lidhin marrëveshje ose kontrata të veçanta në lidhje me marrjen hua të trashëgimisë kulturore të luajtshme të përcaktuar të shtetit.

### Neni 4

Palët caktojnë institucionet e mëposhtme kombëtare të ngarkuara për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe të çdo marrëveshjeje ose kontrate të lidhur në pajtim me nenin 3;

a) Për Republikën e Austrisë: Ministria Federale për Arsimin, Artet dhe Kulturën (dhe Muzeun Shtetëror Historik).

b) Për Republikën e Shqipërisë: Muzei Historik Kombëtar në Tiranë.

### Neni 5

Secila palë do të mbrojë dhe ruajë, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, trashëgiminë kulturore të luajtshme të përcaktuar të palës tjetër ndërsa ndodhet në territorin e saj.

### Neni 6

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy palëve, që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje ose të ndonjë marrëveshjeje apo kontratë të lidhur në përputhje me nenin 3 duhet të zgjidhet me bisedime që do të kryhen në mirëbesim pas një kërkesë me shkrim prej njëres prej palëve.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, brenda tre muajve pas kërkesës me shkrim prej njëres prej palëve, me kërkesën e secilës palë, ajo do t'i drejtohet për vendin Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

### Neni 7

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas njoftimit, përmes kanaleve diplomatike me anë të të cilit palët informojnë njëra-tjetrën për plotësimin e kërkesave të tyre të brendshme ligjore për këtë qëllim.

2. Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa njëra nga palët të njoftojnë palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën 6 muaj përpara, mbi synimin e saj për ta përfunduar atë.

3. Pavarësisht nga çdo përfundim, kjo marrëveshje vazhdon të zbatohet për trashëgiminë kulturore të luajtshme të shtetit në territorin e palës tjetër në kohën e përfundimit derisa ajo të kthehet.

4. Çdo trashëgimi kulturore e luajtshme e shtetit duhet të kthehet në datën më të fundit të përfundimit të kësaj marrëveshjeje ose në datën e parashikuar në marrëveshje apo në kontratë të veçantë.

Bërë në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, gjermanisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëllëj autentike.

**LIGJ**  
**Nr. 98/2012**

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHTETIT PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Miratimi i buxhetit faktik**

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit për vitin 2011, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë lekë

1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	275 479
Shpenzimet, gjithsej	309 297
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	86 267
Shpenzimet	85 317
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	13 965
Shpenzimet	26 974
4. Deficiti buxhetor	- 45 877
5. Financimi i deficitit buxhetor	45 877
I brendshëm	26 119
A. Me instrumente financiare	
(kredimarrje e brendshme, neto)	28 175
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	28 106
Bono thesari	9 947
Obligacione qeveritare 2/3/5-vjeçare	18 159
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	69



B. Të ardhura nga privatizimi	438
C. Të tjera	- 2 494
Ndryshimi i gjendjes së arkës	- 2 283
Të tjera	- 211
Financimi i jashtëm (neto)	19 758
Nga i cili:	
Mbështetje buxhetore	2543

Neni 2  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.10.2012

**Shpallur me dekretin nr.7802, datë 30.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 99/2012**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË 26.9.2012,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 487,  
DATË 5.12.2011 “PËR BUXHETIN E VITIT 2012””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 26.9.2012, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012””.

Miraturar në datën 18.10.2012

**Shpallur me dekretin nr.7803, datë 30.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**VENDIM**

**Nr. 657, datë 26.9.2012**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË AUSTRISË, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHAT E KULTURËS,  
ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunim në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PROTOKOLLI**

**PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR BASHKËPUNIM NË  
FUSHAT E KULTURËS, ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e republikës së Austrisë, *me dëshirën* për të ndryshuar marrëveshjen e bashkëpunimit në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës, të nënshkruar më 31 tetor 2005 në Tiranë, kanë rënë dakord, si më poshtë:

**Neni 1**

Neni 8a shtohet si më poshtë:

“Neni 8a

Palët kontraktuese bien dakord të bashkëpunojnë në ekspozimin e objekteve të tyre të trashëgimisë së luajtshme kulturore në pronësi të shtetit në territorin e palës tjetër. Një bashkëpunim i tillë duhet të kryhet në bazë të marrëveshjes kuadër të mëvonshme, e cila do të negociohet midis palëve dhe që në juridiksionin përkatës të palëve ka forcën e ligjit. Marrëveshja kuadër ka ndër të tjera, kushtet për garantimin e imunitetit të plotë të trashëgimisë së luajtshme kulturore në pronësi të shtetit me juridiksionin civil dhe administrativ të palës tjetër kontraktuese dhe nga të gjitha masat e ekzekutimit ose konfiskimit nga ana e palës tjetër, duke përfshirë edhe masat shtrënguese para ose pas një vendimi të gjykatës për kthimin e objekteve menjëherë pas përfundimit të kohëzgjatjes, rënë dakord për ekspozitën dhe që përcaktojnë juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të gjitha kontestet që dalin nga interpretimi apo zbatimi i marrëveshjes kuadër dhe të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga veprimet e kryera në zbatim të marrëveshjes kuadër.”.



## Neni 2

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën pas së cilës palët kanë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme për hyrjen në fuqi të këtij protokollit.

2. Ky protokoll do të mbetet në fuqi për aq kohë sa dhe marrëveshja për bashkëpunim në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës të mbetet në fuqi.

Bërë në dy kopje origjinale, në gjuhë shqipe dhe gjermane, të dyja tekstet janë njëloj autentike.

### VENDIM

Nr. 712, datë 16.10.2012

#### **PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIT E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KONKURSEVE DHE VEPRIMTARIVE KULTURORE ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në artikullin 604, aparati “Projekte me miratim në art”, t’i shtohet fondi në shumën 15 670 300 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind) lekë dhe në artikullin 602, aparati “Shpenzime operative”, në shumën 3 812 800 (tre milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të konkurseve dhe veprimtarive kulturore me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 713, datë 16.10.2012**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E  
SHPENZIMEVE TË FESTIVALIT TË 13-TË TË FILMIT SHQIPTAR, FESTIVALIT  
MBARËKOMBËTAR TË DRAMËS SHQIPE DHE REALIZIMIN E DRAMËS FITUESE,  
SHPALLUR NË KONKURSIN ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi në shumën 15 706 200 (pesëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e dyqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar, Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe dhe realizimin e dramës fituese “Ëndrra e Ismail Qemalit”, shpallur në konkursin me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 714, datë 16.10.2012**

**PËR KTHIMIN NË ATDHE TË ESHTRAVE TË PERSONALITETIT TË SHQUAR  
SHQIPTAR, MBRETIT ZOG I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kthimin në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar shqiptar, Mbretit Zog I.

2. Ceremonia shtetërore e kthimit në atdhe të eshtrave të Mbretit Zog I dhe homazhet në nder të tij të organizohen më datë 17.11.2012 në Pallatin e Kongreseve.

3. Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Republikën Franceze, të kontaktojë me autoritetet përkatëse dhe të ndjekë procedurat e zhvarrosjes së eshtrave të Mbretit Zog I, të cilat ndodhen në varrezat “Thiais” në Paris, Francë, dhe përcjelljen e tyre deri në Aeroportin “Nënë Tereza”, Tiranë, brenda datës 16.11.2012.



4. Drejtoria e Protokollit të Shtetit, bazuar në Ceremonialin Zyrtar të Republikës së Shqipërisë, të marrë në dorëzim pranë Aeroportit “Nënë Tereza” Tiranë, eshtrat e Mbretit Zog I, të cilat më pas të përcillen pranë morgut të qytetit të Tiranës.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe strukturat përkatëse në varësi të saj të asistojnë Drejtorinë e Protokollit të Shtetit gjatë procedurës së qëndrimit të eshtrave të Mbretit Zog I pranë morgut dhe përcjelljes së tyre sipas traditës në Pallatin e Kongreseve, ku do të kryhen homazhet.

6. Aspektet ceremoniale me rastin e kthimit në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar, Mbretit Zog I, përmbushen sipas parashikimeve të vendimit nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat përkatëse në varësi të saj të zbatojnë detyrimet përkatëse të parashikuara për to nga Ceremoniali Zyrtar i Republikës së Shqipërisë.

8. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohet fondi prej 12 000 (dymbëdhjetë mijë) eurosh, kundërvlehtë në lekë, për përballimin e shpenzimeve të zhvarrosjes dhe transportit të eshtrave të Mbretit Zog I, dhe në programin 01110 “Menaxhim, administrim, planifikim” t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të ceremonialit të varrimit të eshtrave të Mbretit Zog I, në Mauzoleun e Familjes Mbretërore, sipas vlerësimit të fondeve të paraqitura nga Ministria e Punëve të Jashtme.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 31.10.2012  
Doli nga shtypi më 31.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 20 lekë